


PLANI ZHVILLIMOR I SHKOLLES

Planifikimi zhvillimor i shkollës
Programi master në Fakultetin e Edukimit
Dr. Dukagjin Pupovci







Përfshirja në procesin e planifikimit zhvillimor të shkollës

- Këshilli i shkollës dhe drejtori i shkollës – duhet të udhëheqin procesin
- Staf i shkollës (posaçërisht stafi mësimdhënës) – duhet të përfshihet si në planifikimin, ashtu edhe në zbatimin e PZhSh.
- Prindërit – duhet t'u jepet mundësia që të kontribuojnë
- Nxënësit – duhet të shprehin këndvështrimet e tyre
- Palët tjera (zyrtarët e arsimit, përfaqësuesit e biznesit, shërbimet tjera publike, shoqëria civile, komuniteti donator, etj. – duhet të konsultohen në proces

Si planifikojmë me pjesëmarrje?





Ndarja në grupe

- Secili grup duhet të ketë 6-8 anëtarë
- Rekomandohet që anëtarët e grupit të kenë mundësi komunikimi të ndërsjellë edhe jashtë mësimit të rregullt
- Secilit grup do të merret me nga një projekt
- Përgatitni një listë me emrat dhe e-mailat e anëtarëve të grupit.
- Përcaktoni qartë kush është koordinatori

Rasti i simuluar

- Lexoni rastin nga fleta e punës nr. 1
- Diskutoni me anëtarët tjerë të grupit çfarë duhet të bëj shkolla fillore "Flamuri":
 - Ç' proces duhet të zhvillohet në shkollë?
 - Cili është roli i drejtorit?
 - Cili është rezultati i pritshëm?
- Raportoni në emër të grupit!

Analiza e gjendjes në shkollë

- Është hapi i parë
- Quhet edhe kontroll i gjendjes, revizion i gjendjes, apo diagnozë e gjendjes.
- Është proces i vlerësimit real lidhur me çfarë dhe sa është arritur deri tash.
- Është një përpjekje për të vlerësuar drejt arritjet dhe vështirësitë
- Hap mundësi për orientim në të ardhmen

Analiza SWOT


□ SWOT është një shkurtesë në gjuhën angleze për fjalët Strengths, Weaknesses, Opportunities dhe Threats që në gjuhën shqipe kanë këto kuptime:

- Sukseset (arritjet, anët e forta, etj.)
- Dobësitë (mangësitë, anët e dobëta, etj.)
- Mundësitë (oportunitetet) dhe
- Rreziqet (kanosjet, kërcënimet, etj.)

Analiza SWOT

□ Përdorimi i analizës SWOT ndihmon shkollën që:

- të identifikojë **sukseset** për t'i fuqizuar,
- të gjejë **dobësitë** për t'i korrigjuar,
- të shyrtojë **mundësitë** për të shfrytëzuar rastet optimale
- të analizojë **rreziqet** për t'i mënjanuar apo minimizuar



Strengths Sukseset	Sukseset e një institucioni/organizate janë rezultatet që janë arritur nga shfrytëzimi efektiv i resurseve humane dhe materiale që ajo disponon. Fokusimi në sukseset e organizatës/institucionit është bazë e fortë për të shqyrtuar sferat në të cilat ajo shquhet. Cilat janë përparësitë e institucioni/organizatës? Cfarë bëjnë mirë? Cfarë suksese shohin të tjerët tek ne?	Mundësitë janë rastet që vijnë nga rrethina e organizatës/institucionit, të cilat duhet të shfrytëzohen për zhvillimin e institucioni/organizatës dhe për përmirësimin të performancës brenda saj. Cilat janë mundësitë që mund të shfrytëzohen? Cilat janë ndryshimet që mund të përmirësojnë performancën tonë?	Opportunities Mundësitë
Weaknesses Dobësitë	Pikat e dobëta brenda një institucioni / organizate, që reflektohen nga mungesa e rezultateve të dëshiruara paragesin dobësitë. Identifikimi i tyre ndihmon organizatën/institucionin të përqendrohet në përcaktimin e strategjive për mënjanimin e tyre. Cfarë nuk jemi duke bërë si duhet? Cfarë mund të përmirësojmë? Cfarë duhet të shmangim nga puna jonë?	Rreziqet janë faktorët që vijnë nga rrethina e organizatës/institucionit, e të cilët ndikojnë ose kanosin arritjen e rezultateve të dëshiruara. Rrethanat e tilla janë gjithmonë jashtë kontrollit të organizatës ose institucionit. Cilat janë pengesat me të cilat ballafaqohemi? Cilat janë sfidat për t'u adaptuar në rrethanat e reja?	Threats Rreziqet

Punë në grup
Analiza e gjendjes në sh.f. "Flamuri"


Përcaktoni:

Sukseset	
Dobësitë	
Mundësitë	
Rreziqet	

FUSHAT:

1. Ndjekja e shkollës
2. Infrastruktura
3. Komuniteti
4. Cilësia e arsimit
5. Çështje financiare
6. Të tjera

Përdorni imajinatën
 Një kartë-një mendim
 Vendosni numrin e fushës mbi kartë



- Klasifikojmë kartat sipas ngjyrave dhe fushave
- Përcaktohem për ato më prioritare



Planifikimi

- Planifikimi është faza në të cilën shkolla sistemon të gjitha informatat nga faza paraprake në një rrjedhë logjike të objektivave dhe masave për veprim në të ardhmen.
- Në këtë fazë duhet të përcaktohet vizioni zhvillimor i shkollës, qëllimet e shkollës dhe fushat për përmirësim apo prioritetet zhvillimore.

Vizioni

- Vizioni përcakton gjendjen e ardhshme të dëshiruar të një institucioni apo sistemi në aspektin e objektivit kryesor apo drejtimin strategjik
- Vizioni është gjendja që duam ta shohim në mjedisin në të cilin operojmë, gjendje së cilës ne me punën tonë mund t'i kontribuojmë. I



Vizioni jonë është fotografia e së ardhmes sonë që ne krijojmë me imagjinatën tonë. Është dera në fund të shkallëve që do t'i ngjimis, drita në fund të tunelit që do ta përshkajmë.

Vizioni

- Formulimi i vizionit në fushën e arsimit ndryshon nga formulimi i tij në fushën e biznesit.
- Te biznesi përfitues janë vetë pronarët e organizatës. Përfitues tjerë mund të jenë të punësuarit (të cilët marrin paga) dhe familjet e tyre, shteti (i cili mblodh taksat nga biznesi), por edhe klientët (që përfitojnë nga shërbimet apo prodhimet e organizatës).
- Shembull i vizionit për një organizatë biznesi:
 - *Brenda pesë viteve, "ZZZ Tours" do të bëhet kompania kryesore e turneve ekologjike në ... dhe do të rrisë të ardhurat në 2 milionë dollarë në vitin 2014, duke u bërë e njohur ndërkombëtarisht për rehatinë dhe kënaqësinë që turnetë e saja të vëzhgimit të balenave ofrojnë!*

Vizioni

- Tiparet e një vizioni të fuqishëm përfshijnë:
 - Qartësinë dhe mungesën e dykuptimësisë;
 - Tablonë e gjallë dhe të kthjellët;
 - Përshkrimin e të ardhmes së ndritur;
 - Formulimin që mbahet mend dhe të motivon;
 - Synimet realiste;
 - Përputhjen me vlerat dhe kulturën.

Vizioni dhe misioni

- **Vizioni** është gjendja që duam ta shohim në mjedisin në të cilin operojmë, gjendje së cilës ne me punën tonë mund t'i kontribuojmë. I kontribuojmë, por kurrë nuk mund ta arrijmë vetëm.
- **Misioni** është obligimi që ne marrim për të arritur këtë gjendje

Strategjia e Arsimit të Lartë 2005-2015

VIZIONI:

KOSOVA - Shoqëri demokratike e integruar në hapësirën evropiane të arsimit të lartë, ku dija dhe kërkimi shkencor janë në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm kulturor, shoqëror dhe ekonomik

MISIONI:

Zhvillimi i një sistemi të efektshëm të arsimit të lartë që i kontribuon ngritjes së mirëqenies së shoqërisë kosovare duke ofruar një arsimim dhe kërkim shkencor të cilësisë së lartë, me mundësi të barabarta për të gjithë, në pajtim me vlerat e lirisë, demokracisë dhe të diversitetit

Strategjia e Arsimit Parauniversitar 2007-2017

VIZIONI:

Kosova-shoqëri e dijes, e integruar në rrjedha evropiane, me mundësi të barabarta për zhvillim personal të të gjithë individëve, të cilët i kontribuojnë zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe shoqëror.

MISIONI:

Ndërtimi i një sistemi arsimor gjithëpërfshirës, që siguron kushte për formim cilësor të të gjithë individëve duke kultivuar shprehje të të nxëniet gjatë gjithë jetës dhe vlera të qytetarisë demokratike

Reforma e Administratës Publike 2007-2012

VIZIONI:

Kosova - vend demokratik, i integruar në strukturat euroatlantike, me administratë publike moderne e cila gëzon besimin e qytetarëve dhe siguron zbatim efikas të rolit të shtetit në pajtim me ligjin dhe përkrahë zhvillimin e përgjithshëm të vendit.

MISIONI:

Administratë Publike profesionale, transparente, të përgjegjshme, mbështetur në merita dhe e cila plotëson nevojat dhe kërkesat e qytetarëve dhe institucioneve.

Një shembull për shkollën fillore “Flamuri”

VIZIONI:

Shkollë cilësore, që i kontribuon ndërtimit të kohezionit social dhe ndërkulturor në komunën e Shkabës, si dhe zhvillimit të saj të qëndrueshëm ekonomik dhe shoqëror.

MISIONI:

Ofrimi i kushteve për formim cilësor të të gjithë individëve duke kultivuar shprehje të të nxënësve gjatë gjithë jetës dhe vlera të qytetarisë demokratike

Objektivat

- Plani zhvillimor duhet të mbështetet te tiparet dominuese (etosin) dhe vlerat e shkollës.
- Objektivat natyrshëm dalin nga këtu.
- Zakonisht këto mbesin të pandryshueshme apo të vazhdueshme megjithatë
- kërkojnë rishikim gjatë procesit të planifikimit zhvillimor të shkollës

Objektivat

- Faktorët që e bëjnë një shkollë të mirë
 - Tiparet dominuese pozitive;
 - Udheheqja efektive në të gjitha nivelet;
 - Mësimdhënësit e përkushtuar, të rënë dakord rreth vizionit të shkollës;
 - Pritjet realisht të larta për sjelljen dhe arritjet ndër mësimdhënës dhe stafin tjetër, ndër nxënës dhe prindër;
 - Cilësia e lartë e mësimdhënies dhe të nxënësve;
 - Fokusi i qartë në përvojat mësimore të nxënësve dhe në standardet që ata i arrijnë;
 - Sistemi i zhvilluar mirë i monitorimit dhe vlerësimit të cilësisë së shërbimeve;
 - Kultura e përmirësimit të vazhdueshëm përmes vetëvlerësimit efektiv dhe planifikimit zhvillimor; dhe
 - Vetëdija e stafit mbi nevojën e përditësimit të ekspertizës së tyre profesionale, përmes zhvillimit profesional që reflekton nevojat kurrikulare dhe të tjera të shkollës.

Objektivat

- Disa nga këta faktorë përkthehen në objektiva të shkollës për periudhën e ardhshme planifikuese, duke i artikuluar kështu:
 - Të ofrojmë udhëheqje efektive, të bazuar në vlerat e demokracisë në të gjitha nivelet e jetës shkollore;
 - Të mbajmë standarde të larta të arritjes së nxënësve;
 - Të promovojmë sjellje të qytetarisë demokratike në shkollë;
 - Të përparojmë cilësinë e mësimdhënies dhe të nxënësve në shkollë dhe të zhvillojmë një sistem efikas të monitorimit dhe vlerësimit të cilësisë;
 - Të investojmë vazhdimisht në zhvillimin profesional të stafit shkollor, në varësi nga nevojat mësimore dhe tjera të shkollës.

Objektivat

Rasti i simuluar:

Pothuaj të gjitha këto objektiva janë relevante për shkollën nga rasti i simuluar i dhënë te seksioni i analizës së gjendjes. Duke u marrë me rrethanat që ka shkolla nga rasti i simuluar, do të mund të shtonim edhe ndonjë objektiva, si:

- Të sigurojmë një shkallë të kënaqshme të bashkëpunimit me komunitetin e prindërve
- Të krijojmë kushtet për orar optimal të mësimi, të bazuar në nevojat mësimore dhe jashtë mësimore të nxënësve

Detyrë

- Të përcaktojmë objektivat e shkollës "Flamuri" për periudhën shtator 2011 - gusht 2015
- Në mesin e tyre të zgjedhim ato që janë me përparësi (prioritet)
- Pastaj, për secilin objektiva me prioritet të përcaktojmë aktivitetet përkatëse

Shembuj të planeve zhvillimore të shkollave

FALEMINDERIT
